

një vije e ligjes nuke do të prishet. Aý, pra, që shkel më të vógelen prej ketyre porrosive, a i mesón njerezine t' i shkelin, do të quhet më i vogeli në Mbretërine e qellit; po cilidó, që i zbatón, dhe i predikón, aý do të quhet i math në Mbretërine e qellit.

KUNGATORJA

I drejti do të kujtohet për jetë.

31. Kiri dhe Joani, Anargjendet e Shenjte dhe çudiberes.

PERLESHORJA E ANARGJENDEVE, T. T. IV.

O Shen Anargjendë Kir dhe Joán, vizitónani dhe shëronani; darovisht e múarte, darovisht pra épnajeni.

TE KREMTET E SHKURTIT

1. Vengjilla e Perhasjes se Zotit tone Jesú Krisht; Trifuni, Dëshmori i Shenjte.

PERLESHORJA E SHEN TRIFUNIT, T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Dëshmoret e tu o Zot, me vajtje lot e mundím, kurorc të ndrìqime prej teje múarne, si roge dhe si çperblím; se me fuqine tënde, i rrezuan tiranet; edhe i shtypne djajte, e kuxímt' e të dobët; atá për né po të luten o Krisht Perendí, të shpëtohen shpirtet tona.

2. Perhasja.

PERLESHORJA E PERHASJES, T. I.

Gezohu o hirplote Hyjlíndese Virgjereshe, se prej teje ka lindur Díelli i drejtesise, Krishti Perendia yne, qe ndrit ne erresire. Gezohu dhe ti o plak i drejte, qe prite ne peqirin, çlirimtarin e shpírteve, i cili na dhurój Ngjalljen te gjítheve.

THIRRTORET, T. I, TON URANION

Te papershkrúaren Fjale te permiqénshime, qe rri i fronesuar ne lavdine qellore, e priti Simeoni plak ne peqí, dhe taní perleshome tha, pas fjales sate se pashe me syt' e mi, Shpetimtarin e besníkeve.

Te pá si foshnje o Fjale lindur prej jéteve, prej Atit te panisme Simeoni dhe thirri: Ndruhem te te marr ne krahet e mi, Zot i larte i qíellit, po perleshoje taní sherbetorin tent, Shpetimtár i gjithë shpírteve.

Taní o dyer qellore çéluni hápuni, se fjal' e Perendise, qe ka lindur prej jetesh, taní vullnetarisht na zbriti mi dhé, ne peqí te Hyjlíndeses, qe t' i shpetonje njerezine me perdellím, dhe t' i shpjere ne qíellin.

LAVDI DHE TANI, T. II. Sot Nena Shen Marí, ne tempull shkon me Krishtin, dhe Simeón Profeti, e priti edhe thirri: Taní me perleshó o Zot.

PASVARGJET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Ardhi si foshnje sot, ne témpullin e Zotit, edhe

me gas e priti, ne krahe Simeoni, dhe lypi perleshim prej tij.

Ty si thengjill te pa, Profeti Isaia, po ne peqi te mori, nga dor' e Shen Marise, ne tempull Simeoni plak.

Frike dhe ngazellim, ka ndjere Simeoni, kur mori ne peqirin, Jesune Shpetimtarin, dhe lypi perleshim prej tij.

LAVDI DHE TANI. Prit-e o Simeón, i thoshte Virgjresha, ne krahe Shpetimtarin, dhe Zotin e lavdise, dhe driten e paganeve.

NDENJESORJA, T. I, TON TAFON SU

Gjith' Engjejte ne qell, per çudine po shtangen, dhe njërezit mi dhé, po kendojne me bese, kur shohin sa poshte zbret, Perendia dhe Zot' i Math; plaku sot e mban, ne krahët e pafuqishme, dhe e perqafón, me mallengjim permi zemren, si mprojtes te njeresve.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó*.

T. I, TON TAFON SU

Aý qe mbretcrón, tok me Atin e Shenjte, ka zbritur permi dhé, dhe ka lindur si foshnje, dhe çfaqet posi njeri, Perendia qe s' ka pershkrim, dhe keté e mban, sot ne peqi Simeoni, dhe therrét me gas: Taní o Zot perleshome, se pashe shpetimin tent.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó*.

T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

Foshnjerohet permi dhé, aý qe s' nis e qe s' mbarón, te dyzetat po i mbush, i pakufishmi Perendí, qe te na bindë se lindi prej Virgjereshes, edhe plaku Simeón, e njohu posa e pá, si Zot qe ufanés, i mishëruar per né, pra i therrét me mall dyke pershendoshur: Taní me perleshó, se po te pashe, o jet' e tere botes.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó*.

SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Qe prej djalcrise, shume pasione me leftojne, po ti perkrah-me dhe shpetome, o Shpetimtari im.

Ju qe urreni Sionen, do te turperóheni prej Zotit, dhe do te físhkeni si bari ne zjarr.

LAVDI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, merr jete çdo shpirt, dhe lartësohet ne paqesí, dhe ndriçohet prej njesise Trinisore mistikerisht.

TANI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tere kriesen per jetelindje.

PARGVARGU. Do ta kujtónj emrin tent, ne gjithë brezat e brézave.

UNGJILLI I MËNGJJEZIT PAS LUKAJT

M' até kohë, ishte në Jerusalém një njerí, i quajtur Simeón, edhe ky njerí ishte i drejte dhe devót, edhe e priste ngushellimin e Israelit, edhe ishte i frymësuar prej Shpirtit të Shenjte. Edhe i ishte zbuluar prej Shpirtit të Shenjte qe nuke

do të vdiste pa parë Krishtin e Zotit. Edhe vajti në Shenjteroren me anën e Shpirtit të Shenjtë, dhe e priti djalin Jesú në peqí, kur e prunë bren-
da prínderit sipas ligjes, dhe e lavdëroj Perendi-
në, dhe tha: “Taní perleshje shërbëtorin tënt, o
Zot, më paqe pas fjalës sate, se syt’ e mi janë
shpëtimin tënt, që përgatite përpara faqes së gji-
thë pópujve, drite për të ndriquar paganët, edhe
lavdí për pópullin tënt Israél.”

Psalmi 51 pa zë.

LAVDI. Me nërmjetimet e Hyjlíndesës, o më-
shirëplót, shúaji paudhësít’ e mia

TANI. Me nërmjetimet e Hyjlíndesës, o më-
shirëplót, shúaji paudhësít’ e mia

*Meshirome, o Perendí meshirëplót, edhe shúaji pau-
dhësít’ e mia.*

T. II. Sot Nëna Shen Marí, në tempull shkon
me Krishtin, dhe Simeón Profeti, e priti edhe thi-
rri: Taní më perleshó o Zot.

SHKURTORJA, T. I, O MITRAN.

*Kjo Shkurtore këndohet në Meshe pas Hyrjes së Vo-
gel që më 15 të Jenarit gjer më 9 të Shkurtit.*

Ti që e shenjterove Marinë Hyjlíndëse, dhe pla-
kun Shen Simeón, e bekove në témpullin, arrí e-
dhe taní, o meshirëplót o Krisht Perendí, edhe
shtetin na e shpëtó prej gjithë lúfteve, dhe for-
coji qeveritaret e pópullit, si mprojtes i njëresve.

SHTËPIA

Ejani ta shikojmë Shen Marinë, që ia shpie Krishtin Simeonit. Engjëjtc e shikojnë dhe çuditën, se Perendia dhe krijetari i gjithë njërësve, të cilin nuk e nxë dot e tërë bota, sot po mbahet në krahët e një plaku si foshnjë, si mprojtes i njërësve.

SINAKSARI

Sot, me dy të ketí múaji, kremtojmë Perhasjen e Zotit edhe Perendisë dhe Shpetimtarit tonë Jesús Krisht, edhe këtë ditë Simeoni i Drejtë e priti Jesunë në krahët.

Gjithë sot, kujtojmë Agathodorin, Deshmorin e Shenjtë.

E atí është lavdia dhe fuqia në jetët e jëtëve. Amín.

ZBRITËSORET, T. III,
KHERSON AVISOTOKON

Ketó Zbritesore këndohen që me 15 të Jenarit gjer me 9 të Shkurtit.

I. Fundin edhe burimin e avúshave, díelli një hér' e pá, se si mur u-bënë valat, edhe shkoj Israeli, me këmbë nëpër mes të detit, përtej me këng' e brohorí: Le ta këndojmë Zotin, të lavdëruar me lavdí.

III. Zoti Krisht që i mpron besnikët shpresëplotë, forcojë dhe mproje Kishën e bekuar, që e mbolle me vajtje dhe me gjakun tënt.

IV. Mbulove me virtuta qíellin o Zoti Krisht, kur linde prej Nenes Virgjereshe, dhe u-shpure ne Kishë si foshnje ne peqí, dhe i mbushe te gjitha me lavdí dhe brohorí.

V. Te pá Shen Isaia simbolerisht, mi fron te larte si Perendí, ne Parajsen te rethuar prej Engjercjve, dhe thoshte i mjeri me tmerr: Ja e pashe Perendine si njerí, Zotin Shpetimtarin, qe na ndrit dhe na paqesón.

VI. Kur Simeoni te mori ne krahet, dhe pá shpetimin per pópullin, i gezuar thirri: Ti je Zot' i Math e ti je Krishti.

VII. Hodhe vesen permi zjarr, per Tre Djemte Shpetimtár, edhe linde virgjercisht prej Hyjlíndeses, Perendí edhe Fjalë, beserisht te kendojme, se i bekuar je ti o Perendí edhe Zot.

VIII. Ne flag' e ne zjarr te bashkuar, te Tre Djemat e bekuar te pangare, mun ne mes te furrës te vesuar, te kendonin me lavdí: E bekoni Zotin te gjithë me kenge, dhe e lartësoni perherë dhe per jete.

MADHCSHTIMET, T. III.

Kurre nukë merret vesh, as prej Engjercjsh as prej nesh, ajó qe po ngjan me ty, Nen' e Virgjër Shen Marí.

Simeoni priti sot, Shpetimtarin ne peqí, Zotin e kanúneve, krijëtarin plot me hir.

Krijëtari do shpetím, per Adamin mekatár, dhe banón ne gjirin tent, Nen' e Virgjër Shen Marí.

Gjindj' e njëresve kudó, o Marí te lavderón, dhe me bese te kendón, Nen' e Zotit Perendí.

Eni shihni Zotin Krisht, Perendí mi qell e dhé, qe e mban ne Kishen sot, Simeoni ne peqí.

Shtie syrin permi dhé, dhe termét' i rrept' e ze, dhe si sot nje plak te mban, nje i thinjur ne peqí.

Masha je mistikerísht, qe thengjillin Zotin Krisht, zure mun ne gjirin tent, Zonj' e Shenjte Mariám.

Dó dhe vjen posi njerí, i panismi Perendí, dyzét ditet kur i mbush, merr urate dhe bekím.

Kur prej qiellit na zbret, Zot i Math e Perendí, ne peqirin ty te pret, Prift' i Shenjte Simeón.

Shpirtin ma ndriçó o Zot, edhe syt' e trupit tim, te te shoh te te leçít, Perendí o Zoti Krisht.

Nen' e Virgjjer Shen Marí, si ne Kische sot po sjell, dhe si foshnje po ja jep, Simeonit Zotin Krisht?

Perdellím taní te lyp, krijetari im hirplót, se te pash' o Zoti Krisht, drita dhe shpetimi im.

Atí Engjejte ne qell, i pergjunjen me tmerrím, dhe até e pret mi dhé, Simeoni ne peqí.

LAVDI. O Triní me Veta Tre, edhe nga natyra Nje, rúaji besónjesit, dhe sherbénjesit e tu.

TANI. O Hyjlíndese Marí, shpres' e te Krish-téreve, mproji edhe rúaji, adhuronjesit e tu.

O Hyjlíndese Marí, shpres' e te Krish-téreve, mprona rúajna se ti, streha jon' e vetem je.

IX. Ne Ligjen dhe Shkronjen fáqeza, shohim shembell te Zotit Krisht: Çdo djal' i parelindur

kish prej Zotit, hir edhe bekím. Dhe né pra Fjalën që lindi, si Bir i parë në qell, dhe djal' i parë përmi dhé, me këndím e madheshtojme sot.

DËRGIMËSORJA, T. III, EPESKEPSATO

Në pëqí të priti sot, edhe të thirri plot me gas: Me përleshó taní o Zot, pas fjalës sate paqerisht, se të kam parë sot me sy, shpëtím i Israelit, dhe drit' e pagáneve (*§ here*).

LAVDËRIMET, T. IV, EDHOKAS SIMIOSIN

Ligjen e Shkriptúrave, po e mbarón njeridáshesi, edhe sillet në témpullin, atjé Simeoni plak, po e pret në krahët, me gëzím dhe thotë: Zot përleshomë taní, se syt' e mi e panë shpëtimin tënt, se ja ku sot e kam ketú, Zotin Jesú Jetedhënesin, që ka zbritur mi dhé për né, për shpëtimin e njëresve.

Drita e pagáneve, mi dhënë ndrite o Zoti Krisht, përmi retë dhe mjégullat, u-çfaqë si Díelli, dbove erresirën, hien e kanunit, solle mbarím dhe plotësím, me hirin tënt edhe me Ungjillin tënt, kështú pra Simeoni plak, të pá dhe thirri me zë të math: Përleshomë taní o Zot, se me sy të shikova sot.

Linde mishërisht mi dhé, po nuk u-ndave nga qíelli, ti që mbahesh prej kráheve, të Zonjës Hyjlíndese, Nenes Virgjëreshë, dhe sillesh në témpull, ku Simeoni plak të pret, dhe lavdëron Përendinë plot me gas, dhe thotë Përleshóm' o Zot,

se ja e pashe shpetimin tent, qe gatite per njerezit, se te pashe ty o Zot.

LAVDI DHE TANI, T. T. II. O Krisht o Perendí, qe u-perunje si nje foshnje njerezore, dhe umbajte prej kráheve te nje plaku, çlirona nga tirania e pasióneve, dhe shpetoji shpirtet tona.

HYRTORJA

Zoti ua leçiti shpetimin gjithë kómbeve. Shpetona o i Bir' i Perendise, qe te mbajti Simeoni ne peqí, né qe te kendojme Alilluia.

SHKURTORJA, T. I, O MITRAN

O Zot qe e shenjterove Marine Hyjlíndese, dhe plakun Shen Simeón, e bekove ne témpullin, arrí edhe taní, o meshireplót o Krisht Perendí, edhe shtetin na e shpetó prej gjithë lúfteve, dhe forcoji qeveritaret e pópullit, si mprojtes i njéresve.

APOSTULLI

Madheshtoje Zotin, o shpirti im. Se e hodhi syrin mi sherbetoren e perunjur.

Prej Letres se Palit per Hebrenjte.

Vellezcr, pa dyshím, mé i vogeli bekohet prej mé te madhit. Edhe ketú marrin te drejta disa njercs qe vdesin, po atjé i merr ay, qe deshmohet se rron. Edhe munt te them qe edhe Leviu, qe merr te dhjettat, i pagúante te dhjetta Abrahemit, se nuk ishte lindur édhe, kur Melkishedeku e hasi Abrahamin. Pra, sikur te vinte plotesimi me anen e priftcrise levitike, e cila ia dha ligjen

pópullit, ç' ishte nevoje të ngrihej një tjetër prift pas úrdherit të Melkishedekut edhe jo të Aaronit? Se posa ndryshohet prifteria, doemós ndryshohet edhe ligja. Se aý, për të cilin i thomi ketó, zbriste nga një farë, e cila nuk e shërbente në altarin. Se është e ditur që Zoti ynë ka lindur nga fara e Judes, për të cilin Moisiu thotë që nuk e merrej me punët e priftërisë. Edhe çështja duket më e çkoqur kur, sipas shëmbëlles së Melkishedekut, ngrihet një tjetër prift, i cili nuk e ka trashëguar priftërinë nga zbritja mishërore sipas ligjes, po me fuqinë e jetës së pambaruar. Se Shkriptura na deshmón: “Ti je prift për jetë pas úrdherit të Melkishedekut.”

UNGGJILLI PAS LUKAJT

M' atë kohë, prinderit e prunë djalin Jesús në Jerusalém, që tja blatonin Perëndisë, sikunder është shkruar në ligjen e Zotit, që çdo mashkull i parëlindur është i Perëndisë, dhe të jipnin për kurbán, sipas ligjes së Zotit, një pale turtuj, a dy zoq pullumbash. Edhe ja ku ishte në Jerusalém një njeri, i quajtur Simeón, edhe ky njeri ishte i drejtë dhe devót, edhe e priste ngushëllimin e Israhelit, edhe ishte i frymesuar prej Shpirtit të Shenjtë, dhe e priti djalin Jesús në peqí, kur e prunë brenda prinderit sipas ligjes, dhe e lavdëroj Perëndinë, dhe tha: “Taní përleshje shërbëtorin tënt, o Zot, më paqe pas fjalës sate, se syt' e mi janë shpëtimin tënt, që përgatite përpara faqes

se gjithë pópujve, drite për të ndriçuar paganet, edhe lavdí për pópullin tënt Israél.” Dhe Josefi dhe e-jema u-çuditne me fjalët, që u tha Simeoni për djalin. Dhe Simeoni i bekój, edhe i tha Marisë: “Ja ky djale do të ngrerë dhe do të rrezonjë shumë veta në Israél, edhe do të gjenjë shumë kundërshtime, edhe një shpatë do ta çponjë zemrën tënde tej përtej, edhe shumë mejtime të fshehta do të dalin në shesh.” Edhe ishte atjé profetesha Anna, e bija e Fanuelit, nga fara e Aserit, e lashtë nga mosha, e cila kishte rrojtur me burrin shtatë vjetë pas virgjërisë saj, edhe taní ishte e ve një tetëdhjet’ e katër vjeç, edhe nukë largohej nga Shenjterorja, edhe falej nat’ e ditë me lutje dhe me agjërime. Edhe kjo, kur arriu keté orë, e lavderonte Zotin, edhe u fliste për djalin gjith’ atyre, që prisnin çpërblimin në Jerusalém. Edhe si i mbaruan të gjitha zakonet e ligjes së Zotit, u-kthyen në Galilé, në qytetin e tyre Nazarét. Edhe djali rritej dhe forcohej nga shpirti dhe nga urtesia dhe nga hiri i Perëndisë.

MADHËSHTIMI I MESHËS, T. III.

O Hyjlíndese Mari, shpërse e të Krishtëreve, mprona rúajna se ti, streha jon’ e vetem je.

Në Ligen dhe Shkronjen fáqëza, shohim shembell të Zotit Krisht: Çdo djal’ i parëlindur kish përtej Zotit, hir edhe bekim. Dhe në pra Fjalën që lindi, si Bir i parë në qell, dhe djal’ i parë përmi dhé, me kendím e madhështojmë sot.

KUNGATORJA

Do ta marr kupen e shpëtimit, edhe do ta përhërrës emrin e Zotit.

3. *Shen Simeoni, Hyjprítesi i Drejte; Anna, Profetsha e Shenjte. Përlëshore dhe Shkurtore e Përhësjes.*

4. *Isidori Pillusioti, Ati ynë Oshenár.*

5. *Agathia, Dëshmorja e Shenjte.*

PERLËSHORJA E SHEN AGATHISË
T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

Shqërra jote o Jesú, më zë të mësh po të tëhërrët: Dhënëtr ty të dëshëronj, dhe nat' e ditë të kërkónj, dhe kryqësohem dhe varrosem tok më Pëgëzimin; edhe vuanj tok më ty, që të gëzohem tok më ty, edhe vdes për emrin tënt, që tok më ty të rronj në qëll; po si një fli të shenjte për më mua që për ty sakrifikohem. Dëgjona lutjet, edhe shpëtoji, shpërtet tona për vdekjes.

6. *Bukoli, Ati ynë Oshenár, peshkopi i Smyrnes; Foti, Ati ynë i Shenjte, Patriku i Kostandinopjes.*

PERLËSHORJA E SHEN FOTIT, T. IV.

Si shok i Apostujve, dhe mësonjes i tërë botes, lutju Zotit të gjithësisë o Shen Fot, t' i dhuronjë paqen botes, dhe shpërteve tona përdëllimin e mësh.

7. *Shen Partheni, peshkopi i Lampsakes; Lukáj, Oshenari i Stirisë.*

PERLGSHORJA E LUKAJT OSHGNARIT, T. T. IV, EN SI PATER AKRIVOS

Ti o Atë pikerisht, u-tregove shembell e Zotit, se e more Kryqin tent, dhe pasove Zotin Krisht, dhe vepra çfaqe për mesim, që të kujdësemi për trup, se shkon me nxitim, dhe të kujdësemi për shpirt, se është i pavdekur; pra shpirti yt po gezohet tok me Çngjeytë, o Shen Luká i lumur lavdí me ty.

8. *Shen Theodori Stratellati, Deshmori i Math; Zaharia, Profeti i Shenjte.*

PERLGSHORJA E THEODORIT STRATELLA- TIT, T. IV, O IPSOTHIS

O Athllofór i ushterisë vërtetë, o gjenerál i Kryezotit të qellit, u-lavdërove o Shen Theodór Stratellát, se me armë dhe me ment, dhe me besë lehtëve, tufat e demónëve, i dermove me forcë, dhe u-tregove mundës me lavdí; të lumërojme, pra me besë gjithënjé.

PERLGSHORJA E ZAHARISË, T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

I stolisur përfiterisht, Profét i Shenjte Zaharí, pas kanunit Hebraík, therore shpinje besërisht, dhe hollokoste mi alltarin e Perëndisë; keshtú u-bere yll, dhe prift i shenjte mistík, dhe çfaqë botërisht, një hir të hýjeshme, me fjal' e veperim dhe vdiqë me shpatë brenda në témpullin; Pro-

fét i Krishtit, me Shen Joanin, per shpetimin tone lútjuni.

9. *Nikifori, Deshmori i Shenjte.*

10. *Shen Harallambi.*

PERLESHORJA E SHEN HARALLAMBIT, T. IV, TAKHI PROKATALLAVVE

Kollón' e patúndeshme, e Kishes o Harallámp, kandíl i pashúarshme, i terc botes o Shenjt, u-çfaqe plot me lavdí; ndrite mi terc dhene, me deshmím dhe me vojttje, shove paganizmen, e mallkuar dhe t' erret. Pra lutu prane Zotit Krisht, te shpetohen shpirtet tona.

THIRRTORET, T. T. II, OLIN APOTHEMENI

Veten qe ne djalerí, ia dedikove te Lartit, edhe ngrite Kryqin tent, edhe pas i ré Perendise Zotit Krisht; e spastrove trupin tent, prej çdo pasioni, more hirin qe prej qíellit, per çfaredó sherím, dhe per çdo çudí mirebérese; shkelqeve si Deshmór me nam, edhe s' te tronditi asnjé mundím; çdo tmerr e durove, me forcen e atí qe vdiq mi Kryq, pra nermjetó gjithenjé per né, per ndjesen e me-kátave.

E mberthyen trupin tent, me gozhda dhe me perona, po durove çdo mundím, o Deshmór me nam o Shen Harallámb; se s' u-thye shpirti yt, mendja jote s' u-trondít, kur kufoma jote krejt u-shtyp, se ne zemer kishe mall, edhe zjarr te shenjte prej qíellit; keshtú pra vojte çdo mjerím,

me fuqin' e Kryqit qe lartazi; o Deshmor i ndriçim, o shok i Shpetimtarit Jesú Krisht, pra nermjetó gjithenjé per né, per ndjesen e mekátave.

Gas fitove dhe lavdí, dhe nder dhe fame ne boten, me anen e vójtjeve, dhe taní gezohesh ne qell me Engjçjte; meshctár dhe Oshcnár, o Deshmor Shen Harallámp, o ushtár o kryetrím me nam, qe i dermove krejt, gjithc ushterít' e demóneve; e derdhe gjakun si reké, dhe kudó shkelqeve me hirin tent; me ndihmen e Zotit, ke ngjallur te varrósurit ne dhé, pra nermjetó gjithenjé per né, per ndjesen e mekátave.

LAVDI DHE TANI, T. T. I. Ejani o besnike te defrejme shpíterísht, ne panairin e Deshmorit Athlofór, se na fal sherime per semundjet e trupit, edhe nermjetón per shpetimin e shpírteve tona.

PASVARGJET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Gjithc besniket sot, gezohen dhe kremtojne, kujtimin e nderuar, te Hierodeshmorit, te Shenjte Harrallámp me nam.

Bere kudó çudí, sherove çdo lengate, ketú pra jemi mbledhur, dhe po te lavdërojme, i Shenjte Harallámp me nam.

Mblídhuni sot ketú, o djema o besnike, me kenge e kendoni, me mall e pershendoshni, te Shenjtin Harrallámp me nam.

LAVDI DHE TANI. Arke plot me florí, dhe shtembe plot me manne, Marí o Nën' e Shenjte,

perpara Krishtit lutu, per ndjesen e mekátave.

NDENJGSORET, T. III, THIAS PISTEOS

Ndrite me shkelqím, edhe me vepra, shove çdo gabím, te heresive, si nje ushtár i Zotit Krisht o Shen Harallámp; dhe i dermove ushterít' e demónëve, edhe u-çfaqe tropeprures dhe fitimtár; o Deshmór me nam, iu-lut Perendise Zotit Krisht, te na dhuronje ndjesen e mekátave.

LAVDI DHE TANI. Zonje Shen Marí, banés' e Fjales, Nen' e Zotit Krisht, o Virgjereshe, qe kapercén nga bukuria gjithe Çngjajte; hith nje sy ketú mi né qe te lútemi, se prej mekátave te zeza po mbýtemi. Birit pra iu-lut, o Nene Marí Hyjlíndese, shpetimin te na fale mekátareve.

T. IV, EPEFANIS

Na ke lindur si nje yll, nga an' e lindjes, dhe besniket i ndrícón, me çudiberje dhe me hir, Shen Harallámp o Deshmór me nam, pra ta nderojme, te kremten e hýjeshme.

LAVDI DHE TANI. Virgjereshe mprójtese, per çdo nevoje, nermjetó per gjithë né, qe kemi shpresc permi ty, dhe na shpetó prej rezíkeve, o Nen' e Krishtit, o ndihm' e besníkeve.

T. III, TIN OREOTITA

Jeten e ndrícime, Deshmór i Zotit Krisht, edhe deshmimin tent, plot me lavdí dhe nder, bota e tere e levdón dhe thote e ngazelluar: Tok po e

nderojme sot, ditën tendë të ndërçime; thyej çdo armik të zi, i degjuar Shen Harallámp; dhe shpe-
tona nga reziket dhe gezona, në Parajsen e Shenjtóreve.

LAVDI DHE TANI. Zonjë Hyjlíndese, Nena e Zotit Krisht, shpirtin që m' u-semúr, eja dhe ma sheró, se jam i mbytur plotërisht prej fájeve Vir-gjereshë; ty pra të therrës me mall, dhe me zemër renkónjese: Prit-me e panjóllshime, mekatarin vajtónjesin, që po të pershendósh posi Engjelli: Gezohu o Zonjë Hirplote.

SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Që prej djalerisë, shumë pasione më leftojnë,
po ti perkrah-me dhe shpëtoje, o Shpëtimtari im.

Ju që urreni Sionen, do të turpëroheni prej Zo-
tit, dhe do të físhkeni si bari në zjarr.

LAVDI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, merr
jetë çdo shpirt, dhe lartësohet në paqësi, dhe ndri-
çohet prej njesisë Trinësore mistikërisht.

TANI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, rjedhin
burimet e hirit, dhe vaditin tërë kriesën për je-
telindje.

PARGVARGU. Perëndia ka bërë çudira me
Shenjtoret.

UNGJILLI I MENGJEZIT PAS LUKAJT

Zoti u-tha Dishépujve: Rúajuni nga njërczit,
se do tju kapin, dhe do tju ndjekin, dhe do tju do-
rezojnë nëpër sinagoja dhe nëpër burgje, dhe do

tju shpien perpara mbréterve dhe princërve per emrin tim. Dhe kjo do tju behet per dëshmím. Vendosni pra ne zemrat túaja te mos paremejtoni se qysh do te mpróheni, se une do tju jap goje dhe urtesí, te cilen nuke do te mundin ta perballin kundërshtaret tuaj. Dhe do te dorzóheni edhe prej prínderve edhe vellézerve dhe gjirinjve dhe miqve, edhe disa prej jush do te vriten, dhe do te jini te urryer prej te gjítheve per emrin tim, po asnjé qime e kokes suaj nuke do te humbase. Do ta zoteroni shpirtin me durimin tuaj.

Psalmi 51 pa ze.

LAVDI. Me nermjetimet e Athloforit, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndeses, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe shúaji paudhesít' e mia.

T. II. Gjithe besniket sot, gezohen dhe kremtojne, kujtimin e nderuar, te Hierodëshmorit, te Shenjte Harallámp me nam.

SHKURTORJA, T. IV, EPEFANIS

Si thesár te math e ka, Kisha e Shenjte, kokën tende o Dëshmór, i lavderuar kryetrím, dhe tropeprures Shen Harallámp; sot pra gezohet, dhe Zotin e lavderón.

SHTËPIA

Ejani ta nderojme Shen Harallambin e lavde-

ruar, ushtarin e Krishtit edhe Deshmorin e Math; se leftó j per Ungjillin e Krishtit, edhe i permby-si ídhullat, edhe e qertó j mbretin e paudhe, edhe vdiq i vrare si Deshmór. Perandáj Kisha Ortho-dokse e kremtón, edhe gezohet, edhe Zotin e lav-derón.

SINAKSARI

Sot me dhjete te ketí múaji, kujtojme Hara-llambin, Hierodeshmorin e Shenjte.

Gjithe sot, Bapti dhe Porfiri, Deshmoret e Shenjte, e mbaruan jeten te vrare me shpate.

Gjithe sot, te Tria Grate e Shenjta qe besuan, e mbaruan jeten te vrara me shpate.

Gjithe sot, kujtojme Parthenin, Ennathane, Valentinin dhe Palin, Deshmoret e Shenjte.

Gjithe sot, kujtojme Anastasin, Atin tone te Shenjte, kryepeshkopin e Jerusalemit.

Me nermjetimet e tyre, o Perendí, meshiro-na. Amin.

ZBRITCSORET, T. III, KHERSON AVISOTOKON

I. Fundin edhe burimin e avúshave, díelli nje hér' e pá, se si mur u-bene valat, edhe shkoj Is-raeli, me kembe neper mes te detit, pertéj me keng' e brohorí: Le ta kendojme Zotin, te lavde-ruar me lavdí.

III. Zoti Krisht qe i mpron besniket shprese-ploté, forcoje dhe mproje Kishen e bekuar, qe e

mbolle me vojtje dhe me gjakun tent.

IV. Mbulove me virtuta qëllin o Zoti Krisht, kur linde prej Nenes Virgjreshë, dhe u-shpure në Kishë si foshnjë në peqí, dhe i mbushe të gjitha me lavdí dhe brohorí.

V. Të pá Shen Isaia simbolërisht, mi fron të lartë si Perendí, në Parajsen të rethuar prej Gnjecjve, dhe thoshte i mjeri me tmerr: Ja e pashe Perendinë si njerí, Zotin Shpëtimtarin, që na ndrit dhe na paqesón.

VI. Kur Simeoni të mori në krahët, dhe pá shpëtimin për pópullin, i gezuar thirri: Ti je Zot' i Math e ti je Krishti.

VII. Hodhe vesën përmi zjarr, për Tre Djem të Shpëtimtar, edhe linde virgjërisht prej Hyjlíndesës, Perendí edhe Fjalë, besërisht të këndojmë, se i bekuar je ti o Perendí edhe Zot.

VIII. Në flag' e në zjarr të bashkuar, të Tre Djemat e bekuar të pangarë, mун në mes të furrës të vesuar, të këndonin me lavdí: E bekoní Zotin të gjithë me këngë, dhe e lartësoni përherë dhe për jetë.

O Hyjlíndese Mari, shpres' e të Krishtëreve, mprona rúajna se ti, streha jon' e vetem je.

IX. Në Ligjen dhe Shkronjen fáqëza, shohim shëmbell të Zotit Krisht: Çdo djal' i parëlindur kish prej Zotit, hir edhe bekím. Dhe në pra Fjalën që lindi, si Bir i parë në qell, dhe djal' i parë përmi dhé, me këndím e madhështojmë sot.

DERGIMCSORET, T. II, TIS MATHITES

I frymesuar lavderísht, me zellin e Shenjtórcve, e shtrive gjárperin perdhé, Satanin e pashpirtme, qe i mundón njerezine, ne token dhe ne Ferrin, dhe qerove tiranin pagán pa ment, Harallámp i Shenjte i lavderuar, dhe more rogen si qperblím, nga Zot' i gjithesisë.

O Shen Marí Hyjlíndese, mprona prej çdo reziku, mprona prej hidherímeve, mprona prej çdo nevoje, dhe mos na ler te na marre, djalli ditën e funtme, as Ferr' i erresírave, mprona perpara gjyqit te Birit tent, nxirna faqebardhe o Virgjeshë, si Nen' e Zotit ti i ke, qe te gjitha ne dorë.

LAVDERIMET, T. I, TON URANION

Eni besnikë te gjithë mblídhuni sot ketú, qe ta kremtojme ditën, te shenuar per Kishën, te Hierodeshmorit Shen Harallámp, qe leçiti ner njerezit, besën e shenjte te Krishtit edhe deshmoj, per shpetimin e besnikëve.

U-nemërove taní me Engjejt' e qiellit, edhe qendrón i lumur, me te djathten e Zotit, atjé pra nermjetón per né gjithenjé, qe nderojme kujtimin tent, edhe te lútemi gjithë perunjërsisht, per shpetimin e besnikëve.

Plot me shkelqím na ka lindur dita e ndrícime, kujtím' i lavderuar, i Dëshmorit me fame, te Shenjtit Harallámp qe mblídhemi sot, ta kremtojme me brohorí, edhe t' i lútemi gjithë perunjërsisht, per shpetimin e besnikëve.

LAVDI, T. T. I. Koka jote e çemuar, o Shen Harallámp i lavderuar, na burón sherime per secundjet, i pushón murtajat, edhe u fal te gjithëve meshire dhe shpetím.

TANI. Arke plot me florí, dhe shtembe plot me manne, Marí o Nen' e Shenjte, perpara Krishtit lutu, per ndjesen e mekátave.

SHKURTORJA, T. IV, PROSTASIA

O mburónj' e patronditur e te Krishtëreve, nermjetare e palodhur e besníkeve, ver-u veshin mekatáreve me dhempsherí, se po te therresim beserísht, o Nen' e Zotit Jesú Krisht, o Marí Virgjreshë: Ndiha me nermjetimet, dhe lutjet meshireplote, dhe mpro perhere gjith' atá, qe te lusin o Hyjlíndese.

Neqóftese ka nisur Triodi, nuke kendohet kjo Shkurtore po ajo e Triodit.

APOSTULLI

I drejti do te gezohet me Zotin. Degjoma zerin, o Perendí.

Prej Letres II se Palit per Timothene.

Bir Timothé, forcohu me hirin e Jesú Krishtit, edhe ató, qe ke degjuar prej meje, me shume deshmore, ua dorezó njéresve besnike, te cilet jane te zotet tua mesojne edhe te tjéreve. Edhe duroji te keqiat, si ushtár i mire i Jesú Krishtit. Asnjé njerí, i cili vete ushtár, nuke ngaterrohet ne andrallat e jetes, po perpiqet t' i pelqenje gje-

neralit të vetë. Dhe askush nuk e fiton kuroren e trimerisë veç neqoftese trimeron pas ligjes. Bujku, i cili mundohet, ka të drejtë të marrë një pjesë të pëmeve të pari. Kupetoji atë, që them, edhe Zoti të dhente ment për të gjitha. Kujtoje Jesú Krishtin prej fares së Davidit, i cili u-ngjall së vdekuresh pas Ungjillit tim, për të cilin vuanj të keqia gjer në burkë si nonjë keqberës, po fjala e Perëndisë nukë lidhet me vargónj. Perandáj, i durónj të gjitha për të zgjédhurit, që të gjejnë edhe atá shpëtimin e Jesú Krishtit edhe lavdinë e pasosur.

UNGJILLI PAS JOANIT

Zoti u-tha Dishëpujve: Kjo është porrosia ime, doni njerjatrín. Neqoftese bota ju urrén, díjeni se mua më ka urryer më parë se ju. Sikur të ishit prej botes, bota do tju deshte si të sajte, po meqënëqë nukë jini prej botes, nga e cila ju kam zgjedhur unë, perandáj bota ju urrén. Kujtójeni fjalen, që ju thashe. Nukë ka shërbetór më të math se i Zoti. Atá, që me kanë ndjekur mua, do tju ndjekin edhe ju. Atá, që kanë rúajtur fjalen time, do ta rúajnë edhe túajen. Edhe ketó të gjitha do tju bëjnë për emrin tim, se nuk e njohin atë, që me ka dërguar. Sikur të mos kisha ardhur dhe të mos u kisha folur, nukë do të kishin mëkát. Po taní nukë kanë mëhanë për mëkatin e tyre. Aý, që me urrén mua, urrén edhe tim-Atë. Sikur të mos kisha bërë përpara tyre veprat, të cilat nuk i ka bërë asnjë tjetër, nukë do të kishin

mekát, po taní edhe i kanë parë veprat edhe me kanë urryer edhe mua edhe tim-Atë. Edhe kështu mbushen fjalet e shkruara në ligjen e tyre, që me urryen darovisht. Edhe kur të vinje Ngu-shellimtari, Shpirti i së vertetes, që dergohet prej Atit, të cilin do tju dergónj unë me anën e Atit, aý do të dëshmonje për mua. Po edhe ju dëshmoni, se kini qenë me mua që në krye. Këtë jua thashë, që të mos skandalizoheni. Do tju nxierin jashtë sinagójave, edhe vjen ora, në të cilën atá, që do tju vrasin, do të mburren se i bënë një shërbim Perëndisë.

KUNGATORJA

I drejti do të kujtohet për jetë.

11. *Shën Avllasi, Hierodëshmori; Shën Theodora Augusta.*

PERLESHORJA E SHËN AVLLASIT, T. IV, QË TROPON METOKHOS

Shok i mënyrave, nëkembës i frónëve, u-çfaqë kor' e Dishépujve, zbatove me veperim kudó, çdo teorí edhe predikim; perandáj të verteten e leçite prer' e drejt, dhe për besën leftove gjer në gjak, si një Dëshmor o Shën Avllás, lutju Zotit Krisht Perëndí, të shpëtohen shpirtet tona.

PERLESHORJA E SHËN THEODORES, T. IV, O IPSOTHIS

Permi të gjitha preferove qelloret, o Theodore Mbretërësh' e degjuar, dhe si një Engjell jeten e

ke shkuar mi dhé; Zoti pra te vleresój, per gezimet e qellit, tok me gjithë Engjëjtc, dhe me gjithë Shenjtoret, perpara Mbretit tone Jesú Krisht; atí pra lutju, qe te gjejme perdellím.

12. *Meleti, Ati yne i Shenjte, kryepeshkopi i Antiokiye.*

13. *Martiniani, Ati yne Oshenár.*

14. *Auksenti, Ati yne Oshenár.*

15. *Onesimi, Apostulli i Shenjte.*

16. *Pamfili, Deshmori i Shenjte, me shoket e vete.*

17. *Shen Theodori i Tironit, Deshmori i Math.*

PERLGSHORJA E SHEN THEODORIT TE TIRONIT, T. II, MEGALLA TA TIS PISTEOS

Çudira te medhá bes' e forte po mbarón: Ne furre dhe neper zjarr, si neper újera te flladítura, gezohej Deshmór' i Shenjte Theodór i Math; udoq ne zjarr si hollokóst, si buk' e bekuar per Zotin ne qell u-shpu. Dhe aý po te lutet o Krisht Perendí, te shpetohen shpirtet tona.

18. *Leoni i Math, Ati yne i Shenjte, Papa i Romes.*

PERLGSHORJA E SHEN LEONIT, T. IV, KANONA PISTEOS

Kanún i bescs, edhe kor' e butesisc, mesonjes i perkores, ndrite perpara besníkeve, me te verteten e púnëve; pstrandáj i fitove me perunjesine te lartat, me varferine te pásurat; Ate Shen León Kryeprift i Math, lutju Zotit Krisht Perendí, te shpetohen shpirtet tona.

19. *Arkipi, Apostulli i Shenjte.*
 20. *Leoni, Ati yne i Shenjte, peshkopi i Katanes.*
 21. *Timotheu, Ati yne Oshenár; Shen Stathi, peshkopi i Antiokise.*

PERLESHORJA E SHEN STATHIT, T. II.

O Perendí i Aterve, qe na sillesh gjithenjé, me miresí dhe butesí, mos e kursé perdellimin tent per né; me lutjet e Aterve tane, qeverís-e jeten tone me paqe.

22. *Gjetja e lipsánave te Deshmóreve te Shenjte te Eugjenise.*

23. *Polikarpi, Hierodeshmori i Shenjte, peshkopi i Smyrnes.*

24. *Gjetja e pare dhe e dyte e Kores se çemuar te Shen Joanit, Profetit, Parerëndesit dhe Pagezorit te lavderuar.*

PERLESHORJA E PAGEZORIT, T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Nga dheu na dolli sot, kok' e Profetit Joán, dhe reze te ndrícime, prej shcrimesh u tregón besní-keve; Engjcejte qe prej qellit, po i mbleth me trumbete, njërezit qe prej dheut, i therrét per te kremten, ta lavderojne te gjithë, Perendine Zotin Krisht.

25. *Tarasi, Ati yne i Shenjte, kryepeshkopi i Kostandinopjes.*

26. *Porfiri, Ati yne i Shenjte, peshkopi i Gazes.*

27. *Prokopi Dekapoliti, Ati yne Oshenár.*

PERLESHORJA E SHEN PROKOPIT,
T. T. IV, TES TON DHAKRION SU

Me lote derdhur si reké, shkretetiren e that' e vadite per lerím, dhe me vajtím dhe psherétím, gjer nje qint here peme mblodhe per çdo mundím; u-çfaqe pra si yll, dhe e ndriçove boten me çdo çudí, Prokóp o At' i Shenjte dhe Oshenár, lutju Zotit Krisht Perendí, te shpetohen shpirtet tona.

28. *Basili, Ati yne Oshenár.*

PERLESHORJA E BASILIT OSHENARIT,
T. I, TU LITHU SFRAJISTHENTOS

Qytetár i shkretetires edhe Engjell nga trupi, edhe çudiberes u-çfaqe, Basíl o At i Shenjte; me lutje vengjill' e agjerím, fitove dhuretí te qëllshime, se scmundjet dhe lengatat na i sherón, dhe ndjen mekatat e shpirtit; lavdí atí qe te fali fuqí; lavdí atí qe te dha kurore; lavdí atí qe veperón, me anen tende sherime.

29. *Kasiáni Romani, Ati yne Oshenár.*

TE KREMTET E MARSIT

1. *Evdokia, Deshmorja e Shenjte dhe Oshenare.*

PERLESHORJA E SHEN EVDOKSISE,
T. T. IV, EN SI MITER AKRIVOS

Ti o Nene pikerisht, u-tregove shembell e Zotit, se e more Kryqin tent, dhe pasove Zotin Krisht, dhe vepra çfaqe per mesím, qe te çkujdésemi per trup, se shkon me nxitím, dhe te kujdésemi per